

## Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës

Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik në Universitetin e Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 16.04.2024, solli vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional te dorëshkrimit të temës së doktoratës, me titull, "*Identiteti kulturor i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përball diversiteteve 1990-2023*" të kandidates **Mr.Sc. Mirlinda Vejseli**. Në bazë të vendimit **16-187/1** të datës 16.04.2024, Komisioni në përbërje: **1. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani-mentor, 2. Prof. Dr. Ibish Kadriu-anëtar, 3. Prof. Dr. Qani Nesimi-anëtar, 4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti-anëtar, 5. Prof. Dr. Ardita Abduli-Reka-anëtar**, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor Fakultetit Filozofik i paraqet këtë.

### RAPORT

#### *Për vlerësimin e disertacionit të doktoratës*

##### Të dhënat biografike të kandidatit:

Mr.sc. Mirlinda Vejseli ka lindur më 20.06.1989, me vendbanim në komunën e Tetovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku edhe jeton aktualisht.

Mr.sc. Mirlinda Vejseli është doktorantë i shkencave të Sociologjisë, në drejtimin socio-kulturor në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës. Studimet deridiplomike i kreua më 5.07.2012 në po të njëjtin Universitet më notë mesatare 9.61. Në 12.03.2015, mori titullin magjistër i Sociologjisë, ku me sukses mbrojti tezën me titull "Sfidat e lirisë së njeriut modern: E. Fromm, Z.H.Sarte, Xh.Mill & I.Berlin" me notë mesatare 9.89.

Në nëntor të 2011, do të zgjidhet student i dalluar i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës. Nga tetori i 2013 ajo është e angazhuar si asistent part-time në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin Filozofik, programi studimor Sociologji edhe ku është aktualisht.

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoratës kandidatja Mr. Sc. Mirlinda Vejseli i ka kryer me sukses provimet përkatëse, konferencat doktoriale, dhe obligimet tjera të parapara me rregulloren për studimet e doktoratës të Universitetit të Tetovës.

**Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidatja gjatë studimeve të doktoratës:**

Kandidatja Mr. Sc, Mirlinda Vejseli që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoratës e këndejej, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoratës. Me sukses ka realizuar tre konferencat doktoriale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar disa punime, artikuj shkencorë në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

1. *The intercultural community participation in local and governance: the case of North Macedonia and Kosovo/Journal of Liberty and International Affairs,2021/Vol.7 No.3/ eISSN 1857-9760.*
2. *Albanian women in Macedonia between traditional and modern way of life/ ALBANOLOGJIA international Journal of Albanology, 2023/ Vol.10 No.19-20/ISSN 2545-4919*
3. *Ethnic incidents in the Republic of North Macedonia, as a result of prejudices and stereotypes/Centrum/No.20-2023*  
UDC:316.48:323.1]:316.647.8(497.7)316.723021.463(497.7).
4. Participation in the international conference of doctoral and postdoctoral students in social sciences; *The participation of the assimilation of Albanian in North Macedonia and the implementation of Albanian cultural traditions.* 27-28 May 2021, Romania.
5. Participation at the 8<sup>th</sup> International scientific Conference of the Faculty of Philosophy; *Cultural Diversity and preservation of the culture of origine-the specific case of the Republic of North Macedonia.* 15-17 November 2023

## LËNDA E HULUMTIMIT

Ky studim trajton çështjen e identitetit kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përballë diversiteteve. Tema në fjalë është fokusuar në identitetin kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë, lufta për ruajtjen e vlerave tradicionale shqiptare si dhe ballafaqimi me shumë llojshmérinë e kulturave të ndryshme të cilat bashkëveprojnë në formë të llojullojshme. Gjithashtu, duke mos anashkaluar edhe identitetin kulturor mbar shqiptar, për arsyen se shqiptarët jetojnë në rrrafshë paralele, krijojnë vlera dhe identitete në përmasa të shumta horizontale, duke lënë boshtin vertikal që i ndërlidh ato.

Identiteti kulturor është një derivat i identitetit shoqëror dhe ai përkufizohet si gërshtimi i kontekstit personal dhe kulturor brenda aksionit shoqëror. Identiteti kulturor i referohet kontekstit të solidaritetit shoqëror, ku idealet e një grupei kulturor, qëndrimet, besimet dhe sjellja e anëtarëve të grupit, manifestohen në të njëjtën mënyrë nga të gjithë anëtarët që i përkasin atij grupei për shkak të solidaritetit që ata shfaqin me anëtarët e grupit të vet. Duke pasur parasysh bashkëjetesën e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut me maqedonët dhe të tjerët, mund të rrezikohet identiteti kulturor, ndoshta jo si asimilim por një akulturim. Akulturimi shqiptar ka filluar të zërë vendin e kulturës shqiptare ose të paktën të jetë një nga horizontalet legjitime të indit kombëtar. Rruajtja e identiteti kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si dhe përballja me ndryshimet kulturore, është temë që do trajtim dhe reflektim sociologjik, mbi çka edhe është ndërtuar çdo hipotezë brenda kësaj sfere dhe brenda këtij punimi.

Meqë identiteti kulturor i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përballë diversiteteve, nuk është studiuar mjaftueshëm nga qarqet shkencore aq më tepër në aspektin sociologjik, ndaj mendoj se ky studim merr një rëndësi të veçantë, duke dhënë ndihmesë në këtë drejtim. Në një kontekst ku jeta shoqërore sa vjen e bëhet më e intensifikuar dhe e ndërvarur në marrëdhëniet mes kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme, mungesa e ndërgjegjësimit ndërkulturor dhe diversitetit kulturor mund të bëhet shkas për lindjen e stigmatizimeve dhe paragjykimeve problematike, ashtu si edhe të sjelljeve konfliktuale e deviante në shoqëri.

Ky studim i përqendruar në fushën e sociologjisë së kulturës, i dedikohet identitetit kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përballë diversiteteve. Termi identitet kulturor i referohet identifikimit ose ndjenjës së përkatësisë ndaj një grupei të caktuar, bazuar në kategori të ndryshme kulturore, duke përfshirë, etninë, racën, gjininë dhe fenën. Ndërkaq sa i përket diversitetit kulturor, bazuar në Deklaratën Universale mbi Diversitetin Kulturor; Nenil - Diversiteti kulturor:

trashëgimia e përbashkët e njerëzimit theksohet se: "Kultura merr forma të ndryshme në kohë dhe hapësirë. Ky diversitet mishërohet në veçantinë dhe pluralitetin e identiteteve të grupeve dhe shoqërive që përbëjnë njerëzimin. Si një burim shkëmbimi, inovacioni dhe krijimtarie, diversiteti kulturor është po aq i nevojshëm për njerëzimin sa është biodiversiteti për natyrën. Në këtë kuptim, ajo është trashëgimi e përbashkët e njerëzimit dhe duhet njobur dhe afirmuar për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm"

Duke patur parasysh ndikimet nga konteksti multietnik i vendit siç është rasti në MV. Identiteti kulturor i shqiptarëve në MV, përballet me divesitet të pasur kulturor. Ky ndërveprim mund të shërbejë si një burim pasurie kulturore, por edhe si sfidë në ruajtjen e identiteti në një ambient me diversitet të lartë kulturor.

## QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi kryesor i këtij studimi ka qenë të verifikojë relacionin mes nivelit të identitetit kulturor shqiptar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me shkallën e diversitetit shoqëror dhe akulturimit të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Në këtë kontekst si synim i studimit janë trajtuar, lidhjet e të gjitha përmasave të identitetit kulturor, si gjuha, traditat, zakonet, gjuha, arti, muzika, feja dhe veshja në raport me përmasat e diversitetit kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si akulturimi, distanca sociale, kujdesi nga institucionet, përshtatja dhe asimilimi, perceptimi i rrëzikut nga kulturat e përkatësive tjera etnike. Në veçanti fokusi i këtij studimi është orientuar të gjejë se sa ka ndryshuar perceptimi i shqiptarëve për identitetin e tyre kulturor nga diversiteti kulturor i mjedisit në të cilin jetojnë. Gjithashtu studimi krahasonë diferençat gjinore, sipas vendbanimit, shkallës së arsimimit, përkatësisë fetare dhe vendbanimit në shkallën e identitetit dhe diversitetit kulturor te shqiptarët e RMV-së. Prej qëllimit të lartshënuar, më poshtë konkretisht janë paraqitur objektivat e studimit.

### *Objektivat e studimit*

Ky studim ka synuar të arrijë këto objektiva:

1. Të verifikojë ndërlidhjen mes shkallës së përgjithshme të perceptimit të identitetit kulturor të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut me diversitetin e tyre shoqëror dhe akulturimin;

2. Të verifikojë përmasën e parashikimit të ndryshimit të identitetit kulturor shqiptarë të RMV-së nga shkalla e diversitetit kulturor dhe akulturimit, me përmasat e tyre;
3. Ekziston korrelacion negativ mes identitetit kulturor
4. Ta gjejë relacionin mes njohurive të shqiptarëve për artin e tyre dhe akulturimin në mjesdit në të cilin jetojnë;

#### *Pyetjet e hulumtimit*

Pyetjet e studimit të cilat ky studim i parashtron bazuar në objektivat e caktuara, janë:

1. Cila është ndërlidhja mes shkallës së përgjithshme të identitetit kulturor të shqiptarëve të RMV-së me diversitetin kulturor?
2. Cila është përmasa e parashikimit të ndryshimit të identitetit kulturor të shqiptarëve të RMV-së nga shkalla e diversitetit kulturor?
3. A ekziston ndërlidhje mes shkallës së përgjithshme të identitetit kulturor të shqiptarëve të RMV-së me përmasat e diversitetit kulturor, akulturimit dhe asimilimit?

#### HIPOTEZAT E KËRKIMIT

1. Ekziston marrëdhënie negative mes shkallës së përgjithshme të identitetit kulturor të shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut me diversitetin e tyre kulturor.
2. Ekziston korrelacion negativ mes identitetit kulturor dhe përmasat të diversitetit kulturor (asimilim, akulturim dhe roli i institucioneve),
3. Ekziston ndërlidhje negative mes vetëvlerësimit dhe ndjenjave kulturore dhe diversitetit kulturor, akulturimit dhe asimilimit te shqiptarët e RMV-së,
4. Ekziston ndërlidhje negative mes zbatimit të traditave dhe zakoneve me diversitetin kulturor, akulturimit dhe asimilimit te shqiptarët e RMV-së,
5. Ekziston ndërlidhje negative mes rëndësisë së gjuhës me diversitetin kulturor, akulturimit dhe asimilimit te shqiptarët e RMV-së,
6. Ekziston ndërlidhje negative mes vlerësimit të muzikës dhe artit shqiptar me diversitetin kulturor, akulturimit dhe asimilimit te shqiptarët e RMV-së,
7. Ekziston ndërlidhje negative mes rëndësisë së fesë me diversitetin kulturor, akulturimit dhe asimilimit te shqiptarët e RMV-së,

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologja është pjesë tjeter e rëndësishme e cila është përfshirë në këtë punim dhe është pjesë përbërëse, e rëndësishme gjatë shtjellimit dhe elaborimit të punimit në fjalë.

Andaj në kuadër të këtij projekti është paraparë që të shfrytëzohen metoda siç janë:

*Metoda e analizës së përbajtjes* - ku analizohen tekste dhe dokumentacioni tjeter si tekste mësimore, strategji të arsimit, ngjarje kulturore dhe historike, etj.

*Metoda historike* - mundëson njohjen e problemeve identitare që nga e kaluara e deri në ditët e sotme.

*Metoda e komparacionit* - mundëson krahasimin e të dhënave të deritanishme me të dhënat dhe gjetjet e këtij hulumtimi

*Metoda e analizës teorike* - kjo metodë mundëson që para hulumtimit të analizohen të dhëna teorike në lidhje me këtë problematikë, literaturën përkatëse profesionale, për t'u njohur me afër me identitetit kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si dhe me problematikat dhe përparësitë që sjell bashkëjetesa mes dy kulturash.

*Metoda statistikore* - me anë të kësaj metode shprehen në mënyrë statistikore rezultatet e nxjerra nga anketimi përmes pyetësorit, duke bërë të mundur shprehjen e të dhënave në mënyrë tabelare, në mënyrë grafike, pastaj vlerësimin dhe shprehjen e vlerave. Me ndihmën e kësaj metode shpjegohen edhe raportet shkak –pasojë, respektivisht ndryshimet që ndodhin tek identiteti kulturor i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si pasojë e diversitetit kulturor.

### Teknikat dhe instrumentet e kërkimit

#### Pyetësori

Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave sasiore është pyetësori.

Numri i respondentëve në kuadër të këtij hulumtimi kuantitativ është 480 respondent.

Ky target grup është përzgjidhur nga më tepër qytete të Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë rajonin e qytetit të Tetovës, Shkupit, Strugës, Dibrës dhe Manastirit, me qëllimi që të shihen ndikimet reciproke të kulturave në rrrafshin gjeografik, me të cilat këto qytete kufizohen.

Target grupet në kuadër të këtij hulumtimi janë paraparë që të janë:

Korpusi i grup moshave mbi 18 vjet,

Korpusi i grup moshave sipas gjinisë

Korpusi i grup moshave sipas ambientit fsha /qytet,

Target grUPI përfshinë edhe aspektin e demografisë, përkatësisht të dhënAT demografike të pjesëmarrësve në hulumtim.

## PËRPUNIMI I TË DHËNAVE STATISIKORE

Analiza statistikore është realizuar përmes programit kompjuterik për përpunimin e të dhënave në shkencat sociale SPSS. Statistikat e përdorura në këtë studim janë ata parametrike në rastet kur plotësohen kushtet e normalitetit dhe kërkesave tjera statistikore, po ashtu edhe statistika jo parametrike në rastet kur natyra e të dhënave dhe cilësia statistikore ka qenë e përshtatshme për këto lloje statistikash.

Analizat korrelacionale janë aplikuar për gjetjen e hipotezave të cilat supozojnë ndërlidhjen, ndërsa analizat e krahasimit për hipotezat të cilat synojnë krahasimet mes grupeve të pavarura apo mes faktorëve të caktuar. Në të dhënrat të cilat i plotësojnë kushtet për analiza parashikeuse ose gjetjen e efekteve statistikore është përdorur edhe regresioni linear i thjeshtë dhe i shumfishtë. Rezultatet janë konsideruar të rëndësishme statistikisht deri në nivel .05 të besueshmërisë statistikore.

## REZULTATET E HULUMTIMIT

Natyrisht që ky punim rezultojë me një unifikim të dhënave që janë paraqitur në forma të ndryshme, me një studim sociologjik për një periudhë tejet të rëndësishme, për shoqërinë shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përtej ekzaminimit të rr Ethanave e situatave historike studimi ofronë një qasje të re sociologjike që provon të nxjerr në pah identitetin kulturor të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut si dhe ndryshimet që ndodhin si pasojë e faktorëve të ndryshëm.

Si rezultat i zgjerimit të mëtejshmë të këtij punimi, studimi mund të nxjerrë edhe një përmasë multidiciplinar, i cili do t'i u ndihmojë jo vetëm sociologëve dhe kulturologëve por edhe autorëve, studiuesve dhe atyre që janë të pasionuar pas çështjeve identitare dhe kulturore.

Punimi “Identiteti kulturor i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përball diversiteteve 1990-2023” pritet që te jetë një literaturë shtesë dhe e hollësishme për sa i përket studimeve sociologjike dhe kulturore në përgjithësi dhe të analizuar ne veçanti për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky punim për dallim prej punimeve ekzistuese ishte me gjithëpërfshirës dhe me i detajuar pasi analizon identitetin kulturor të shqiptarëve në MV në periudhë më të gjatë kohore dhe duke shqyrtuar më shumë variabla në krahasim me studimet paraprake. Gjithashtu punimi është një risi në qarqet akademike, dhe i patrajtuar në aspektin sociologjik.

### VLERËSIM DHE PROPOZIM

Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratës ne baze vendimit Nr.16-187/1 të datës 16.05.2024 nga Këshilli mësimor shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës dëshiron te njoftojë Këshillin Mësimor Shkencorë me vlerësimin e tij për punimin e doktoratës me temë “Identiteti kulturor i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përball diversiteteve 1990-2023” të dorëzuar nga kandidatja Mr.sc. Mirlinda Vejseli.



Pas një vlerësimi të kujdeshshëm, komisioni arriti në përfundimin se kandidatja posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në fushën e shkencave sociologjike. Punimi i dorëzuar nga kandidatja shërben si model i shkëlqyer qe ilustron qasjen e duhur dhe metodologjinë për kërkimet doktorale.

Bazuar në karakteristikat dhe cilësitetë e paraqitura në punimin e doktoratës dhe në cilësitetë e vërtetuara te kandidates, Këshillit mësimor shkencor me kënaqësi propozojmë:

1. *Miratimin e Raportit te punimit të doktoratës me temën. “Identiteti kulturor i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut përball diversiteteve 1990-2023” të dorëzuar nga kandidatja Mr.sc. Mirlinda Vejseli.*
2. *Lejimin e mbrojtjes së punimit të doktoratës nga kandidatja.*

Për besimin tonë në cilësitetë shkencore të kandidates dhe kontributin e vlefshëm që ajo sjell në fushën e shkencave sociologjike, shpresojmë që Këshilli Mësimore Shkencorë të miratojë këtë propozim dhe të japë mundësinë për zhvillimin e procesit të mbrojtjes së punimit të doktoratës i cili posedon kualitetet e nevojshme për të realizuar studime kërkimore-shkencore në fushën e shkencave sociologjike, ndërsa ky punim paraqet shembullin se si duhet të jetë qasja e kandidatëve gjatë përpunimit të një punimi te doktoratës.

Anëtarë të komisionit:

1. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani – mentor 
2. Prof. Dr Ibish Kadriu – anëtarë 
3. Prof. Dr. Qani Nesimi – anëtarë 
4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti – anëtarë 
5. Prof. Dr. Ardita Abduli – anëtarë 

Tetovë, 2024